



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura V**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 28  
Prishtinë, më 11 maj 2016, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303

**PROCESVERBAL**  
**I Mbledhjes së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ali Sadriu, Naim Fetahu, Fikrim Damka, Hajdar Beqa dhe Abdyl Ymeri.

**Munguan:** Besnik Bislimi, Bali Muharremaj, Synavere Rysha dhe Enver Hoti.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës; Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ.

**Pjesëmarrësit e tjerë në takim:** Ibrahim Gylderen, Qëndresa Mulaj, Valbon Bytyçi, Emine Fazliu, Zuk Zuka, Fatlinda Ramosaj, Vlora Mehmeti dhe Bujar Bajraktari, nga ZAP; Agnesa Haxhiu, KDI; Florina Ejupi, BIRN dhe Norë Shabani, “Koha ditore”.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.5.2016;
3. Shqyrtimi i raporteve kthyese të organizatave buxhetore, për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike;
4. Të ndryshme.

*Zëvendëskryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Zëvendëskryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.5.2016

*Zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 4.5.2016, pa vërejtje.*

## 3. Shqyrtimi i raporteve kthyesë të organizatave buxhetore, për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike

**Ali Sadriu (zëvendëskryetar)**, theksoi se në këtë mbledhje, Komisioni ka vendosur të diskutojë për raportet kthyesë të organizatave buxhetore, për të cilat Komisioni ka dhënë rekomandime, gjatë shqyrtimit të raporteve të auditimit, të përgatitura nga ZAP-i për vitin e kaluar. KMFP ka arritur të shqyrtojë 58 raporte të auditimit, duke përfshirë këtu edhe raportin vjetor të auditimit të ZAP-it, për vitin 2014. Po ashtu, gjatë shqyrtimit të raporteve të auditimit, KMFP ka arritur t'i nxjerrë mbi 84 rekomandime, ku një pjesë e këtyre rekomandimeve kanë kaluar edhe përmes seancës plenare.

Vlen të theksohet se një pjesë e rekomandimeve kanë qenë të lidhura me afate kohore, megjithatë shumica prej këtyre organizatave buxhetore, nuk kanë kthyer raportet kthyesë, sipas afateve kohore të caktuara me rekomandime. Rekomandimet janë dhënë për këto organizata buxhetore: Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Shërbimin Policor të Kosovës; Doganën e Kosovës; Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Ministrinë e Administratës Publike; Ministrinë e Financave; Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Integritimit Evropian.

Aktualisht, deri tani, raporte kthyesë kanë dorëzuar këto organizata buxhetore: Ministria e Integritimit Evropian, lidhur me raportin e auditimit të PVF-ve, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor të vitit 2014; Ministria e Shëndetësisë, lidhur me raportin e auditimit për performancën e sistemit të prokurimit në sektorin e shëndetësisë; Ministria e Financave, përkatësisht Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm, lidhur me auditorët e brendshëm dhe funksionalizimin e njësive të auditimit; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Administratës Publike.

Vlen të theksohet se një numër i konsideruar i rekomandimeve kanë dalë nga shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit, për vitin 2014. Duke pasur parasysh situatën në të cilën jemi, ku një numër i konsideruar i organizatave nuk kanë dorëzuar planet e veprimit, por edhe ato të dorëzuara, në disa raste, nuk konsistojnë me ato të kërkuara nga Komisioni. Unë, personalisht, kam menduar që ne, si Komision, t'i analizojmë këto plane të veprimit, ku për ato organizata buxhetore që kanë dorëzuar planet e veprimit, t'i thërrasim në një takim të radhës së Komisionit, ndërsa për ato që deri më tani nuk kanë dorëzuar planet e veprimit, Komisioni të vendosë mënyrën e qasjes dhe trajtimit të tyre. Së bashku me administratën e Komisionit, si dhe me deputetët e Komisionit, është mirë që të kemi një ndarje të raporteve kthyesë, për secilin deputetë, në mënyrë që mos të kemi vonesa në trajtimin e të gjitha raporteve kthyesë, në mbledhjen e radhës së KMFP-së.

Pra, ne kemi një propozim konkret për ndarjen si vijon: **Hajdar Beqa**, dy raporte për MAP: raporti vjetor i Auditimit të PVF-ve për vitin 2014, si dhe raporti i performancës për mirëmbajtjen edhe servisimin e veturave. **Synavere Rysha**, dy raporte të auditimit për MF: raporti vjetor i auditimit të PVF-ve për vitin 2014, si dhe raporti i performancës për mirëmbajtjen

dhe servisimin e veturave ( Dogana e Kosovës). **Fikrim Damka**, MSH: një raport për sistemin e prokurimit në sektorin e Shëndetësisë. **Naim Fetahu**, dy raporte të auditimit për MMPH-në: raporti vjetor i auditimit të PVF-ve për vitin 2014, si dhe raporti për auditimin e pasqyrave vjetore financiare për vitin 2014 për MMPH-në. **Abdyl Ymeri**, KGJK: dy raporte për performancën financiare për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave për KGJK-në, si dhe Policinë e Kosovës.

Lidhur me këtë, hapi diskutimin.

**Hajdar Beqa**, theksoi se në parim, pajtohem që të kemi një qasje të një analizë më konkrete në planet e veprimit. Propozoi që këto takime të mbahen në ndërtesën e Kuvendit, e jo në organizatë buxhetore. I rendësishëm në këtë proces është bashkëpunimi me auditorët që kanë kryer këto auditime.

**Ibrahim Gylderan** (ZAP), tha se Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, gjatë vitit 2015, ka dorëzuar në KMFP një numër të konsideruar të raporteve, për të cilat KMFP ka nxjerrë edhe rekomandime. Po ashtu, gjatë auditimit të ndërmjetëm, rekomandimet janë trajtuar vetëm pjesërisht, për faktin se auditimet e performancës marrin më tepër kohë. Sipas rekomandimeve të KMFP-së, gjatë vitit 2015, ZAP ka arritur t'i bëjë tri auditime të performancës: për pajisjet medicinale, sistemi informativ shëndetësor, si dhe trajtimi i pacientëve jashtë vendit. Po ashtu, ZAP-i është në proces të përgatitjes së këtyre raporteve të rregullsisë për këto organizata buxhetore: për MMPH-në, MAP-në, KGJK-në, MIE-në, MPMS-në dhe Doganat e Kosovës. Vlen të theksohet se të gjitha auditimet e rregullsisë, janë në proces e sipër dhe do të përfundojnë nga mesi i muajit qershor. Më pastaj, individualisht, të gjithë auditorët morën fjalën, për të arsyetuar të gjeturat gjatë auditimeve të ndërmjetme.

**Ali Sadriu (zëvendëskryetar)**, theksoi se KMFP ka një plan për të vizituar të gjitha organizatat, për të cilat kemi dhënë rekomandime, dhe së bashku me stafin mbështetës të KMFP-së, deputetët dhe auditorët, të organizojmë takime të ndara me organizatat buxhetore, për të diskutuar planet e veprimit, në kontest të adresimit më të mirë të rekomandimeve.

#### *Përfundim*

*KMFP, vendosi t'i vizitojë organizatat buxhetore, për t'i shikuar se sa janë adresuar rekomandimet e dhëna nga KMFP. Lidhur me këtë, individualisht, administrata do të përgatisë raporte.*

#### **4. Të ndryshme**

Në këtë pikë, nuk pati diskutime. Me këtë u mbyll takimi.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Zëvendëskryetari i Komisionit,**

---

**Ali Sadriu**